

# REMEMBER / KUJTO

## THE FATES OF ALBANIAN SURVIVORS IN MAUTHAUSEN / FATET E TË MBIJETUARVE SHQIPTARË NË MAUTHAUSEN

*More than 512 Albanians were interned from Albania to German concentration camps. They were sent to Zemun, Banjica and then to other Camps in Austria and Germany. 427 Albanians died in all the filials of Mauthausen camp, according to a placque in the walls of Mauthausen. Only 24 survived in Mauthausen, when Allies liberated the Camp in 5 May 1945. One of them went to America, while 23 others returned to Albania.*

Rreth 512 shqiptarë u internuan nga Shqipëria në kampet e përqendrimit naziste. Ata u dërguan në kampet jugosllave, Zemun e%t Banjicë dhe më pas në kampet gjermane në Austri e Gjermani. 427 shqiptarë mendohet se kanë hyrë në portat e Mauthausenit dhe filianeve të tij sipas një pllake të vendosur në murin e kampit. Vetëm 24 shqiptarë mbijetuan në Mauthausen kur aleatët çliruan kampin në 5 Maj 1945. Një prej tyre shkoi në Amerikë, 23 të tjerë u kthyen në atdhe.





A project by DMO ALBANIA  
In cooperation with National Historical Museum



Financed by EVZ Stiftung Foundation, Berlin

## REMEMBER / KUJTO ■ ■ ■ ■

Project leader: Eva Kushova  
Historian: Dorian Koçi  
Curator: Elton Koritari  
Communication: Silvia Çala  
Documentary: Admirina Peçi, Dean Anadolli  
Exhibition Design: Marsej Fuçia  
Brochure Design: EJAbum



EJALBUM

[www.remember.al](http://www.remember.al)

## RRETH KËTIJ PROJEKTI

Ekspozita “Fatet e shqiptarëve të mbijetuar në Mauthausen” është pjesë e një projekti dy vjeçar, një ide e organizatës DMO ALBANIA (Destination Management Organisation, me seli në Tiranë) në bashkëpunim me Muzeun Historik Kombëtar, e financuar nga EVZ Stiftung Foundation (Foundation “Remembrance, Responsibility and Future”, me seli në Berlin). Thelbi i projekteve të financuara nga ky fondacion është sjellja në kujtesë dhe mbajtja gjallë e dëshmimeve dhe historive të atyre që vuajtën nga Nacional Socializmi - Gjermania naziste e viteve 33-45. Për viktimat dhe familjarët e tyre, njohja e vuajtjeve është po aq e rëndësishme sa kompesimi financiar apo dënimi i fajtorëve. Ata meritojnë t’u njihen vuajtjet. Për Shqipërinë kjo pjesë e historisë ka qenë e patreguar më parë. Ka patur disa intervista me 1-2 të mbijetuar, por nuk janë mbledhur asnjëherë faktet historike në një studim të vetëm.

Stafi i DMO Albania, në bashkëpunim me historianin Dorian Koçi, punuan për të dokumentuar fatin e shqiptarëve që u arrestuan nga nazistët në operacionet e dimrit 43-44 dhe u dërguan në kampet e përqendrimit para se të çlirohej Shqipëria. Pse në Mauthausen? Sepse aty ka shkuar kontigjenti më i madh i shqiptarëve të arrestuar nga gjermanet në vitet 43-44 në Shqipëri. Fillimisht, u bë një vizitë e stafit tonë në Mauthausen, Austri, për të parë nga afër kampin, memorijen e mbledhur aty, barakat ekzistuese, vendin ku kanë vuajtur edhe shqiptarët, edhe pse për një periudhë të shkurtër 19 mujore.

Puna vazhdoi me një studim historik të thelluar mbi fashizmin në Shqipëri që nga ardhja e italianëve, gjermanëve e deri të çlirimit i Shqipërisë, e më pas ndjekja e historive të të internuarve deri në vitin ‘45 dhe kthimin e tyre në atdhe. Nga studimi u evidentuan disa emra të të mbijetuarve dhe familjarëve të tyre, të cilët u kontaktuan dhe u intervistuan për t’u bërë pjesë e një dokumentari të dedikuar të titulluar “Nga ferri në Ferr”. U quajt kështu sepse disa të mbijetuar nga Mauthauseni, vuajtën sërish në burgjet e diktaturës komuniste.

Ekspozita ishte hapi i radhës, ku përveç studimit kronologjik, shfaqjes së dokumentarit vjen për publikun shqiptar dhe një seksion edukues, për t’ua përcjellë këto ngjarje brezave të rinj.

Projekti nuk mbaron këtu. Këtë pjesë të historisë do e dokumentojmë në kurrikulat e shkollës, që të mësohet që në bankat e shkollës.

Dhe në fund, disa seminare me shkollat e mesme, konkurs esesh me nxënësit për të marrë përshlytjet e tyre në prozë, poezi apo dhe grafikë se si e shohin ata këtë periudhë të vuajtjes së shqiptarëve në kampet e përqendrimit nazist.

E kaluara nëse nuk njihet mirë, nëse nuk nxjerrim mësim, mund të përsëritet në çdo kohë. Detyra jonë është të edukojmë sa më mirë brezat e rinj, për të mos lejuar më që njeriu të shfaroset dhe deningrohet në atë mënyrë nga një qenie tjetër njerëzore siç ndodhi në Luftën e Dytë botërore.

**EVA KUSHOVA**  
Director of DMO ALBANIA

## ABOUT THIS PROJECT

*The exhibition “The Fates of Albanians who survived the Mauthausen camp” is part of a two-year project, an idea of DMO ALBANIA (a non-profit organisation based in Tirana) in cooperation with National Historical Museum in Tirana, financed by EVZ Stiftung Foundation (Foundation “Remembrance, Responsibility and Future”, based in Berlin, Germany).*

*The aim of this project is to keep alive memories and stories of people suffered during National Socialism regime in Germany during 1933-1945. Victims feel that recognition of the suffering they have endured is just as important as financial compensation or punishment for perpetrators. They deserve their suffering being recognised.*

*For Albanians, this part of history was unknown until today. There were some interviews with one or two survivors, but not a documented history, with facts, figures, photos, artefacts etc.*

*In the first phase of the project, DMO Albania in cooperation with historian Dr. Dorian Koçi worked for the research to document the fate of Albanians who were arrested by Nazi Germany during 1943-1944 in Albania and sent to concentration camps. Why Mauthausen? Because, the biggest contingent of Albanian prisoners, more than 500 people, were sent toward Mauthausen, initially in the camps of Zemun and Banjica with final destination Austria.*

*Our staff visited Mauthausen memorial site in July 2021, to see the place, the barracks, the museum and to collect information about the Albanian memories there. Further research continued in Albanian Archives and International Archives about the itineraries of Albanian internees from Albania to Mauthausen, the names of arrested people, of the dead and survivors from the camp. We contacted their families and interviewed them. All the interviews become part of a documentary produced in November by our staff. The documentary is titled: From hell to Hell, because of one of protagonists, who survived in Mauthausen, but was arrested four times during Communism regime in Albania.*

*The exhibition is the highlight of the project. We wanted to share with the public all the facts and documents we collected during our research, the stories of survivors and translate all these stories into an education mission for new generations. The exhibition will move in Durrës and Vlora, in the cities with the most victims of National Socialism.*

*The project is not ending here. The second part has to do with educational activities, to include this part of history in the curricula of High School. We will organize workshops with students of high schools in three cities, and will call an essay competition, awarding the best works of students regarding this part of history.*

*Our duty is to educate young generation, to encourage them to learn the lessons of the past and to make sure that they never forget what happened with humankind 77 years ago.*

**EVA KUSHOVA**  
Director of DMO ALBANIA

## KONTEKSTI HISTORIK

Lufta e Dytë Botërore është cilësuar si lufta më shkatërrimtare e njerëzimit, si lufta me humbjet më të mëdha njerëzore. Që nga shek. i XVII asnjë luftë në Europë nuk kishte qënë kaq mizore dhe me kaq shumë shkatërrime. Tani paqja ishte rikthyer, por shumë e kuptuan se ajo ishte paqe e ngritur mbi një varrezë. Kjo varrezë njerëzore nuk u shkaktua nga njerëz që u shndërruan në kriminelë brenda ditës, por ishte rezultat i dhunës së një aparati të sofistikuar represiv mbi qëniet njerëzore. Nazizmi gjerman si ideologjia që lindi përmes të ashtequajturit revolucion racial që promovonte "diferencat nga natyra" – superiorët mbi të tjerët dhe darvinizmin social, shkaktoi humbjet më të mëdha njerëzore në histori. Rreth 75 milion njerëz vdiqën në Luftën e Dytë Botërore, përfshirë rreth 20 milion personel ushtarak dhe 40 milion civilë, shumë prej të cilëve vdiqën për shkak të gjenocidit të qëllimshëm, masakrave, bombardimeve masive, sëmundjeve dhe urisë. Lufta e Dytë Botërore ishte një luftë religjioni, apo në terma moderne, lufta e ideologjive nga të dyja anët. Ajo që gjithashtu, - edhe këtu faktet flasin vetë, - një luftë për jetë a vdekje me shumicën e vendeve pjesëmarrëse. Çmimi i disfatës përballë regjimit nacional-socialist gjerman, siç u vërtetua në Poloni e në pjesën e pushtuar të Bashkimit Sovjetik dhe me fatin e hebrenjve, zhdukja sistematike e të cilëve iu bë e njohur shkallë-shkallë një bote mosbesuese, ishte skllavërimi dhe vdekja. Rezistenca antifashiste në Shqipëri përfshiu shumë njerëz, fate njerëzore e personazhe që do të shenjonin historinë e mëvonshme 50-vjeçare së Shqipërisë, ndër ta dhe njerëzit e internuar në Kampin e Përqëndrimit në Mauthausen, Austri në periudhën nëntor 1943-maj 1945. Krimet e nazizmit kanë nevojë të evidentohen dhe të vihen në një rrafsh krahasues me vendet e tjera të kontinentit evropian. Të vdekurit dhe të gjallët nga Shqipëria që vuajtën në Kampin e Mauthausen-i në Austri patën nevojë për një drejtësi tranzicionale pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, e cila në shumë raste nuk u arrit. Respektimi i viktimave dhe dëshmitë e mbledhura nga pasardhësit e kampit të Përqëndrimit të Mauthausen-it janë dëshmi referenciale që dëshmojnë triumfin dhe nganjëllimin e dinjitetit njerëzor mbi banalitetin e së keqes. Kjo ekspozitë i kushtohet kujtimit të tyre.

**Dr. Dorian Koçi**  
Drejtor, Muzeu Historik Kombëtar

## HISTORICAL CONTEXT

*The Second World War has been described as the most devastating war of humanity, as a war with the greatest human losses. Since the XVII century, no other war in Europe had been so cruel and destructive. Now peace was restored, but many realized, as the poet did at the end of the Thirty Years' War, that it was a peace raised above a cemetery<sup>1</sup>. This human graveyard was not caused by people who turned into criminals overnight but was the result of the violence of a sophisticated repressive apparatus over humans. German Nazism as the ideology that arose through the so-called racial revolution which promoted "differences by nature" - superiority over others and social Darwinism, caused the greatest human losses in history. About 75 million people died in World War II, including about 20 million military personnel and 40 million civilians, many of whom died as a result of deliberate genocide, massacres, mass bombings, disease, and starvation. This was a war of religion, or in modern terms, the war of ideologies on both sides. It was also, here too, the facts speak for themselves, a life-or-death struggle with most of the participating countries. The price of defeat against the German National Socialist regime, as proved in Poland and in the part which was occupied by the Soviet Union and with the fate of the Jews, whose systematic disappearance became known step by step to an unbelieving world, was slavery and death. The anti-fascist resistance in Albania included many people, human destiny and characters who would mark the later 50-year history of Albania, among them the people interned in the Concentration Camp in Mauthausen (Austria) during November 1943-May 1945. The crimes of Nazism need to be identified and compared with other countries of the European continent. The dead and the living people from Albania, who suffered in the Mauthausen Camp, need transitional justice after the end of the Great War, which in many cases failed. The respect for the victims and the testimonies gathered from the descendants of the Mauthausen Concentration Camp are reference evidence that testifies to the triumph and exaltation of human dignity over the banality of evil. This exhibition is dedicated to their memory.*

**Dr. Dorian Koçi**  
Director of National Historical Museum



**FATET E TË MBIJETUARVE SHQIPTARË NË MAUTHAUSEN**

***THE FATES OF ALBANIAN SURVIVORS IN MAUTHAUSEN***

**Beqir Xhepa**, njeriu që jetoi nga ferri në ferr Beqir Xhepa është një nga protagonistët kryesorë shqiptarë të mbijetuar nga Kampi i Mauthausenit, Austri. Lindi më 26 shtator 1928 nga një familje e vjetër tiranase. Që i vogël ai u bë korieri personal i Qemal Stafës. Në moshën 15 vjeçare në operacionin e dimrit 43-44, Beqiri u arrestua dhe me të burgosurit e dimitir 43-44, Beqiri u dërgua në burgjet e Zemunit dhe Banjicës, Jugosllavi e më pas përfundoi në Mauthausen. Duke qenë minoren, nuk u dërgua të punonte në guroren e tmerrshme të kampit, por bashkë me fëmijë të tjerë jugosllavë u ngarkuan detyra të ndryshme në spital, në kuzhinë etj. Ai ishte ende gjallë, kur çlirohet kampi në 5 Maj 1945. Kur u kthye nga Mauthauseni, Beqiri mbaroi studimet e larta në Fakultetin Histori-Filologji, u martua e krijoi familje. Fillimisht u përshtat me sistemin komunist, por pastaj filloi të shprehej lirshëm për gjërat që dinte. U arrestua dhe u burgos 4 herë për agjitacion e propagandë nga vitet 1970-1985. Fjalët e tij: "Këtë që ma bëri diktatura, nuk ma bëri as Mauthauseni janë skalitur në shumë intervista që ai ka dhënë". Ai ka shkruar një libër që nuk e botoi kurrë dhe ka ruajtur disa artefakte nga Mauthauseni, numrin e tij original të burgut, si dhe një shishe hiri nga trupi i djegur i shokut të tij Kozma Nushi. Beqir Xhepa u nda nga jeta në 15 prill 2016.



*The man who lived from hell to hell*  
Beqir Xhepa is one of the main Albanian protagonists surviving from the camp of Mauthausen (Austria). He was born on September 26th, 1928 to an old family from Tirana. From an early age he became the personal courier of Qemal Stafa. At the age of 15 in the winter operation of 43-44, Beqiri was arrested by Nazi troops. He was sent to

Zemun and Banjica prisons in Yugoslavia for some months, and then ended up in Mauthausen camp. As a minor, he was not sent to work in the terrible quarry of the camp, but together with other children from Yugoslavia he was assigned various tasks in the hospital, in the kitchen, etc. He was alive in May 1945 when the camp was liberated. When he returned from Mauthausen, Beqiri completed his studies at the Faculty of History and Philology. He was married and worked as operator in Kinostudio "Shqipëria e Re", then he was the chairman of the publishing

house. But he began to speak freely against the dictatorial system. He was arrested and imprisoned 4 times from 1970-1985. His words: What the dictatorship did to me, not even Mauthausen did to me have been sculpted in many interviews he has given. He wrote a book he never published and has preserved some artefacts from Mauthausen, his original prison number, as well as a bottle of ashes from the burnt body of his friend Kozma Nushi. Beqir Xhepa passed away on April 15th, 2016.

**Dhimitër Simoni**, njeriu që përfaqësoi Shqiptarët në Kampin e Mauthausen i njohur si Mit Simoni, lindi në Vlorë më 12 janar të vitit 1911. Dyqani i tij i këpucarisë u bë çerdhe e njëjësive guerile dhe e drejtuesve të partizanëve, ku dhe u arrestua bashkë shumë të tjerë. Pushtuesit nazifashistë nisën nëpër kampet e përqendrimit rreth 600 vlonjatë. Megjithatë, falë forcës së tij fizike e shpirtërore, ishte ende gjallë kur Aleatët liruan kampin në 1945. Kur forcat aleate çlirimtare u kërkuan të mbijetuarve të përfaqësoshin me simbolin e atdheut të tyre, Dhimitër Simoni, mori një beze nga fabrika e tekstilit në kamp, dhe skicoi konuret e shqiponjës dykrenore të simbolit të atdheut dhe shkruajti 'Albania'. Më 20 qershor 1945 u organizua një ceremoni funebre, përpara mijëra varreve të heshitura. Aty, çdo shtet i botës u përfaqësua me nga një të burgosur. Dhe Shqipërinë e përfaqësoi Dhimitër Simoni. "Albania" u thirr e para dhe në tasin ku ai kishte ngrenë supën e kampit, aleatët e mbushën dhë nga këto varreza. Në mes të tasit të mbushur me dhe, u ngul simboli i flamurit kombëtar shqiptar, i rrethuar me tela me gjemba si dhe një copë qymyr nga qymyri i djegur që hanin të burgosurit e urritur. Pas kthimit nga Gjermania, Dhimitër Simoni ka qenë me raport mjeko-ligjor (kemp) pra nuk ka punuar. Dhimitër Simoni u nda nga jeta më 19 nëntor 1989.



*The man who represented the Albanians in Mauthausen*  
Dhimitër Simoni, was born in Vlorë on 12 of January 1911. His shoe store became the cradle of guerrilla units and the shelter for partisans. During a Nazi operation he was arrested together with many partisans. He was sent out in concentration camps with 600 people from the city of Vlorë. The day of the capitulation of Germany found him alive, though a skeleton, suffered and tortured in the most barbaric way. When the Allied Liberation Forces asked the survivors to be represented by the symbol of their homeland, Simoni took a piece of fabric from the textile factory in the camp, sketched the contours of the double-headed eagle and wrote the words ALBANIA with coal. On 20 of June 1945, a funeral service was held in front of thousands of silent graves. There, each country in the world was represented by one prisoner. Albania was represented by Dhimitër Simoni. "Albania" was

called first and in the bowl where he had eaten the soup of the camp, the allies filled it with soil from massive grave. In the middle of the bowl, the symbol of the Albanian national flag was placed, surrounded by barbed wire and a piece of coal, which is like a bread for prisoners. After returning from Germany, Simoni had a Medical Legal Report and for this reason did not work until the end of his life. Dhimitër Simoni passed away on November 19th, 1989.

**Abdulla Krutani**, njeriu përsëriste deri sa vdiq numrin e kampit Abdulla Krutani nga Tirana, ishte një djalosh 16-17 vjeçar kur u arrestua nga forcat gjermane në vjeshtë të vitit 1943. Fillimisht e çuan në burgun e Tiranës, dhe më pas u transferuan në Jugosllavi dhe prej aty udhëtuan ditë të tëra me tren për në Kampin e Mauthausenit. Vuajtja e urisë nisi që në udhëtimin me tren – tregon Abdullai, - mbaj mend që zgjasnim duart se binte shi jashtë dhe i lagnim për të pirë ujë". Abdullai qëndroi për 19 muaj në këtë kamp, por forca e shpirtit dhe besimi i tij bëri që ai t'i mbijetonte tmerrve në kampin nazist deri në Maj 45 kur u liria kampi. Sa mbërriti në Shqipëri në '45 filloi ushtrinë dhe më pas punoi si mobilier dhe punoi si i tillë deri në fund të jetës. Dy gjëra nuk i shqiteshin Abdulla Krutani nga mendja, uria e tejskajshme në kamp ku hanin gjethe, qymur për të mbajtur shpirtin gjallë. "Qymyri i djegur na dukej si çokollatë- kujton Krutani. Dhe jetra ishte numri i tij i kampit, të cilin ai e solli me vete original nga kampi. Deri në vdekje, Abdulla Krutani thoshte numrin e vet në gjermanisht, sa herë i dilte gjumi. Frika e kampit, se mos nuk thoshte mirë numrin kur ta thërrisnin gjermanët, nuk iu nda. Abdulla Krutani u nda nga jeta më 26 korrik 2020, i fundit i të mbijetuarve nga kampi i Mauthausenit.



*The man who until his death repeated the number of the camp*  
Abdulla Krutani from Tirana, was a 16-17-year-old youngster when he got arrested by German forces in the autumn of 1943. He was first taken to the prison of Tirana, and then transferred to Yugoslavia, from where he travelled by train to the Mauthausen Camp. "The hunger suffering started on this journey on the train," says Abdulla. Arriving at the camp was a nightmare. He stayed there for 19 months, but his strength of spirit and faith made him survive the horrors of the camp until May '45. When he arrived in Albania, he entered the army and then he started doing woodwork and became one of the most distinguished furniture makers at Misto Mame. The extreme hunger in the camp forced them to eat leaves, coal pieces, everything to keep his soul alive. "Even the burnt coal tasted good to us, it was like chocolate". The other thing he remembered was his prison number. Until his death, Abdulla Krutani repeated his number in German, whenever he fell asleep. When the Germans called him, he feared he would not say his number correctly. He lived until the end with that fear. Abdulla Krutani passed away on July 26th, 2020, and was the last survivor of the Mauthausen camp.

**Ahmet Cekaj**, malësori nga Tropoja Historia e Ahmet Zenelit nga Shipshani i Tropojës tashmë është fiksuar në libër me titullin: 'Unë kam qenë në Mauthausen', e shkruar nga historiani Shpend Topallaj. Në 1943, Ahmeti ka qenë në xhandarmëri në burgun e Gjakovës, gardian burgu, nga ku është bërë një thyerje burgu për lirim dhe disa komunistëve të njohur, dhe Ahmeti kishte ndihmuar në këtë operacion. Pas 3 ditësh ai është arrestuar nga forcat Gjermane dhe përfundoi në Kampin Mauthausen. "Në 5 maj '45 kur kapitulloj Gjermania naziste na morën në makina dhe na çuan diku që nuk dihet se ku, pa adresë, ishin të armatosur të gjithë dhe çdo lëvizje që bëje mund të të ikte jeta. Aty s'kuptuam gjë, përse na lanë dhe ikën", tregon ai momentin e lirim. Ahmeti arriti të kthehej gjallë në shtëpi, pikërisht në fshatin e lindjes, ku u shtua dhe u trashëguua me një familje shumë të madhe. Në fillim e pati të vështirë të punësohej si i kthyer nga kampi pasi e mendonin agjent. Fillimet e para kanë qenë shumë të vështira, punët më të rënda në kooperativë dhe një varfëri e madhe, derisa fëmijët 'dhanë prova', përfunduan për sistemin dhe u shkolluan. Ahmet Cekaj u nda nga jeta më 2 korrik 1978.



*The highlander from Tropoja*  
The story of Ahmet Zeneli from Shipshani of Tropoja is already put in the book titled: 'I have been in Mauthausen', written by the historian Shpend Topallaj. Ahmet Zeneli suffered in the Mauthausen prison and managed to return home alive, exactly to his native village, Shipshani. In 1943, Ahmet was in the gendarmerie in the prison of Gjakova, the prison guard, where a prison break was organized in order to release some well-known communists. Ahmeti assisted in this operation. After 3 days he was taken by German forces to end up at Mauthausen. "On May 5th, 1945, when I surrendered to Nazis, they took us in cars to an unknown place, without an address, everyone was armed and every move you made, could determine your life. We did not understand why they left us there and fled". Ahmet Cekaj returned to his native village and enjoyed his children in Tropoja. At first it was difficult for him to be hired as a returnee from the camp after being considered an agent. The start was very difficult, the hardest jobs in the cooperative, deep poverty, until the children gave evidence that they worked for the system and were educated. Ahmet Cekaj passed away on July 2nd, 1978.

## Vangjel Doni

i mbijetuar qe urrente patatet Ka lindur ne 1928 ne fshatin Milgu te Gjirokastrës. Ne moshën 16 vjeçare ka dalë partizan me Brigadën e Ishmit në Tiranë. Gjatë një operacioni u kap nga forcat gjermane, të cilat e dërguan në Jugosllavi, ku ka ndenjur gati 4-5 ditë dhe prej Jugosllavisë është dërguar në burgun e Mauthausenit. Atje kaloi gati 9 muaj, ku provoi torturat çnjerëzore, kryesisht urinë dhe punën e mundimshme për vdekje. Fati e deshi gjithsesi të mbetej gjallë. Historitë e periudhës së errët, Vangjeli i ka lënë shënime para se të ndërronte jetë. Fati e donte që ai t'i mbijetonte kampit. Pas kapitullimit të Gjermanisë, Vangjeli u rikthye në vendlindje, në fshatin e tij ku kishte lënë prindërit, motrën dhe vëllain. Vangjeli u punësua në fshat si polic, dhe pasi bëri shkollën e oficerit u bë kapiten i parë në Përmet. Taqo, djali i Vangjelit tregon disa momente të babait që i kishin lënë gjurmë. Babai nga përvoja e hidhur që kishte kaluar në Mathausen, nuk duronte dot gjellën me patate, pasi siç rrefën ai "në kamp vuanin nga uria dhe për të mbajtur shpirtin gjallë hanin edhe cipat e patateve të gjetura në koshat e mbeturinave". Vangjel Doni u nda nga jeta më 10 maj 2005.



*The man who hated potatoes*  
*Was born in 1928 in Milgu, a village in Gjirokastra. At the age of 16 he became a partisan with the Brigade of Ishëm in Tirana. During an operation he was captured by the Germans, who sent him to Yugoslavia where he stayed for almost 4-5 days. From there he was sent to the prison of Mauthausen. He spent almost 9 months there, where he experienced inhuman tortures, mainly starvation and devastating hard work. He managed to stay alive anyway. After the capitulation of Germany, Vangjel returned to his homeland, in the village where he had left his parents, sister and brother. Vangjeli was later employed in the village as a policeman, and later completed the officer's school and became the first captain in Përmet. Taqo, Vangjel's son tells some moments of his father that had left him traumatized. His father hated the potatoes from the bitter experience he had gone through in Mathausen. "In the camp they found only potato skins in the trashes, and eat them every day to keep the soul alive. Taqo says that although the potato dish was well cooked and had no skin, only the smell terrified his father". Vangjel Doni passed away on May 10th, 2005.*

## Gaço Çomo

grup me italianët Gaço Çomo i lindur nga fshati Dardhë i Korçës, në moshë fare të re bashkë me vëllain e tij Ilo Çomin, u bënë pjesë e grupeve komuniste të Korçës në organizimin e rinisë atëherë kundër fashizmit. Gaço dhe vëllai i tij i vogël u arrestuan nga policia italiane në një nga aksionet që kryenin në Tiranë. Kur u burgos ka qenë në të 20-tat. Fillimisht qëndruan disa javë në burgun e Tiranës, e më pas u transferuan në burgun "Ustika" të Italisë fashiste. Kur kapitulloi Italia, të gjithë të burgosurit politikë ose antifashist u transferuan në burgun e Mathausenit. Gaço kishte tmerr erën e kimikateve kur i dizinfektonin. Kjo ishte gjëja më e neveritshme që mbante mend. Vëllai i tij ndërroi jetë atje, ndërsa Gaço pësoi një të ftohtë dhe ca kohë qëndroi në spital. Duke qenë se vinte nga burgjet italiane, miku më i mirë i burgut të tij ishte një Italian me emrin Tuljo, i cili e ndihmoi deri në fund. Kur kampi u lirua dhe Gaço doli gjallë, askush nga pala shqiptare nuk u shfaq që ta merrte, ndaj ai ka qëndruar rreth gjashtë muaj në shtëpinë e Tuljos në Itali. Pas 6 muajsh vendosi të kthehej në Shqipëri, bëri kursin për ekonomist u martua dhe patën vetëm një fëmijë. Gaço ka disa shënime nga burgun, të cilat gruaja e tij i dorëzoi në Shoqatën e Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare. Gaço u nda nga jeta 63 vjeç, më 31 tetor 1986.



*Group with the Italians*  
*Gaço Çomo was born in the village of Dardhë in Korça and at a very young age, together with his brother Ilo, became part of the communist movement in Korça, organizing the youth against fascism. Gaço and his younger brother were arrested by Italian police in one of the actions, carried out in Tirana. He was 20 years old when he was imprisoned. They initially stayed for several weeks in prison in Tirana. Afterwards they were transferred to the prison of "Ustika" in Italy. Later, when Italy capitulated, all political or anti-fascist prisoners were transferred to Mauthausen prison. Gaço was horrified by the smell of chemicals when prisoners were disinfected in the camp. It was the most disgusting thing he remembered. His brother died there, while Gaço suffered from a cold and stayed in the hospital for some time. Coming from Italy, his best friend in prison was Tuljo, a guy from Italy who helped him till the end. When the camp was liberated and Gaço came out alive, no one from the Albanian state appeared to take him, so he stayed for about six months in Tuljo's house in Italy. After 6 months he decided to return to Albania. He completed an economic course and created a family. Gaço passed away 63 years old, on October 31st, 1986.*

## Vëllezërit Agalliu

një u kthye gjallë Beqir dhe Mehmet Sulo Agalliu ishin aktivë në lëvizjet çlirimtare. Ata morën pjesë në Komitetin drejtues të Luftës për çlirimin e Vlorës nga Italianët në 1920, kurse me ardhjen e pushtimit Italian ishin të parët që morën armët kundër tyre. Po kështu revolta e tyre vazhdoi dhe ndaj pushtimit gjerman. Ranë në sy të armikut dhe si Beqirin dhe Mehmetin gjermanët i arrestuan në vitin 1943. Te dy bashkë i internuan në kampin e përqëndrimit në Mauthausen. Beqiri nuk mundi të dalë i gjallë andej pasi u dogji në krematorium, ndërsa i vëllai i tij Mehmeti u hodh nga treni teksa transportohej për në një nënkamp tjetër. Ai arriti të arratisej, gati në fund të luftës, kur dhe gjermanët ishin si të trullësuar nga humbjet. Pra Mehmeti arriti të kthehej gjallë në atdhe, dhe të rrefente historitë e tmerrve në Mauthausen. Një nga historitë që ai ka treguar është kjo: Gjermanët vunë të ndeshen një shqiptar dhe një polak, dhe kush do humbiste do vdiste. Në kohën që afrohen, shqiptari në gjermanisht i thotë polakut: A je i martuar? Jam. - A ke fëmijë? Kam dy- e më presin. - Atëherë, fito ti! - thotë shqiptari. Shqiptari mund ta mundte se ishte më i ri dhe më i fortë fizikisht. Të tërë u çuditën kur shqiptari u shtri dhe e la polakun të dilte fitues. Shqiptari vdiq. Cdo vit te memoriali shqiptar polaku çonte lule deri sa vdiq, duke ia lënë amanet këtë akt, djalit të tij. Një ditë ambasadori ynë në Vjenë shkoi te memoriali dhe gjen djalin e polakut aty dhe e pyet përse vendos lule te Memoriali Shqiptar? Dhe djali i polakut qe jetoi falë shqiptarit tregon të njëjtën histori. Mehmet Agalliu u nda nga jeta më 6 qershor 1955.



*Agalliu brothers, one came back alive*  
*Beqir and Mehmet Sulo Agalliu were active in the liberation movements. They participated in the Leading Committee of the War for the liberation of Vlora from the Italians in 1920, they fought against Italian occupation and continued their revolt against the German occupation. The enemy noticed them and both Beqir and Mehmet were arrested by the Germans in 1943. They were interned together in the concentration camp in Mauthausen. Beqir was burnt in the crematorium, while his brother was thrown from the train while being transported to another subcamp. Mehmet managed to escape, almost at the end of the war, when the Germans were in chaos by the losses. Mehmet managed to return home alive, and tell the stories of horror in Mauthausen. One of the most interesting stories is: The Germans put an Albanian and a guy from Poland to fight each other. The winner would live and the loser would die. As they approach, the Albanian in German ask the Polish one: Are you married? I am - he says. Do you have children? I have two, and they are waiting for me. - Then, you win! - says the Albanian. The Albanian could have beaten him because he was younger and stronger. Everyone was surprised when the Albanian stretched out and let the Polish guy win the fight. The polish guy survived and every year he came to Mauthausen to put a flower to Albanian Memorial. One day, Albanian Ambassador to Vienna went to the Albanian Memorial and found there a Polish man putting flowers. This man was the son of the Polish guy whose life was a gift from an unknown Albanian prisoner. Mehmet Agalliu passed away on June 6th, 1955.*

## Stefan Konduri

njeriu që 'fuste' në furrë bashkëvuajtësit e tij Stefan Konduri, është arrestuar nga forcat gjermane më 23 nëntor 1943, operacioni i dimrit. Stefani u kap së bashku 50-60 durrsakë të tjerë. I çojnë në Elbasan, pastaj në Bitola (Maqedoni), më vonë në Zemun afër Beogradit, për një muaj dhe më pas drejt Mauthausenit. Aty fillon dhe kalvari i vuajtjeve dhe persekutimeve. Numri i Stefan Kondurit në burg ishte 100 045 A. Atë numër e kishte edhe në dorë të djegur dhe shenjat i kishte derisa vdiq. Stefani i përjetoi të gjitha tmerrret e Mauthausenit. Ai rrefën se me dorën e vet ka futur shumë njerëz në krematorium, disa gjysmë të vdekur, disa të marrë fund. E megjithatë fati e deshi që Stefani të ishte ende gjallë më 5 maj të vitit 1945, kur erdhën forcat çlirimtare amerikane. Kur Stefani u kthye në atdhe, familjarët druheshin nëse do të jetonte normal, pasi kishin frikë nëse i kishin bërë eksperimente dhe injeksione 19 muaj në kamp. Të gjithë bënin vetëm një pyetje: Si ka mundësi që shpëtoi? Megjithatë Stefani rinisi jetën sërisht dhe respektive nga durrsakët. Ai punoi mekanik në kantierin detar ku dhe doli në pension. U nda nga jeta më 22 gusht 1972.



*The man who was forced to burn other prisoners*  
*Stefan Konduri, was arrested by German forces on 23 of November 1943 by the winter operation. Stefan was captured with 50-60 other citizens from the city of Durres. They were sent to Elbasan, then to Bitola and latter to Zemun near Belgrade. He was held in prison in Zemun for a month and then ended up in Mauthausen, where the ordeal of suffering and persecution begins. Konduri's number in prison was 100 045 A. His number was burnt on his hand. He experienced all the horrors of Mauthausen and confessed that with his own hands he put in the crematorium, many people, some of them half dead. The fate was on his side and he survived. When Stefan returned home, family members feared if he would be normal again, fearing they had given him experiments and injections for 19 months in the camp. In addition, everyone asked only one question: How was possible that he escaped, what did he do? However, Stefani resumed his life and was respected by the people of Durres. He worked as a mechanic on the shipyard where he retired. He passed away on August 22nd, 1972.*

## SHPREHJE TË TË MBIJETUARVE

"Hanim qymyr, se na dukej si çokollatë" - Abdulla Krutani.

"Kur vinte supa, nxitonim të tërhiqim një barishte. Ndonjëhere luga na kapte ndonjë cope leckë" - Ahmet Cekaj.

"Ishim aq ngjitur në trena, sa të gjithë rrinim në këmbë për ditë me radhë" - Beqir Xhepa.

"Kush kishte dhëmb floriri, çohet te dentisti, u merej dhëmbi pastaj i digjin në furrë" - Dhimiter Simoni.

"Një i burgosur piu kafe jashtë orarit të ngrënies. E lidhën me kokë poshtë, çfarë nuk i bënë që t'ia nxirnin

" - Beqir Xhepa.

"Flinim me të vdekurit. Shpesh nuk tregonim që shoku ngjitur kishte vdekur, për të përfituar racionin e supës" - Beqir Xhepa.

"Në kamp nuk kishte emra. Të gjithë ishin numra. Kush nuk mbante mend numrin e vet gjermanisht, torturohej rëndë" - Abdulla Krutani.

"I urrej patatet. Ne kamp kishte shumë patate, por ne hanim vetëm lëkurat që hidhnin në kosh gestapot

" - Vangjel Doni.

"Me dorën time kam futur njerëz në furrë, shumica gjysëm të vdekur. Ishte punë, ndryshe përfundoja vetë

aty" - Stefan Konduri.

"Në gurore punonim kot, i ngjismim gurët lart dhe i zbrisnim prapë poshtë, vetëm për të na munduar"

- Fejzo Toska.

"Nuk mbledhnin vetëm dhëmbët e njerëzve, por dhe dhjamin. Se çfarë bënë me të, një zot e di" - Ahmet

Cekaj.

## EXPRESSIONS OF SURVIVORS

"We ate coal, because it looked like chocolate" - Abdulla Krutani.

"When the soup came, we hurried to get any herb. Sometimes the spoon would catch a piece of cloth

" - Ahmet Cekaj.

"We were so close to the trains that we all stood for days" - Beqir Xhepa.

"Whoever had a gold tooth, the tooth was taken first and then he burned in the crematorium" - Dhimiter

Simoni.

"One prisoner drank coffee outside the meal time. They tied him upside down, they did everything to get

him out" - Beqir Xhepa.

"We slept with the dead. Often we did not tell that our friend had died, to benefit his soup ration" - Beqir

Xhepa.

"There were no names in the camp. We were all numbers. Anyone who did not remember his German

number was tortured to death" - Abdulla Krutani.

"I hate potatoes. There were a lot of potatoes in the camp, but we only ate the skins thrown in the trash

by gestapos" - Vangjel Doni.

"With my hand I put people in the crematorium, most of them half-dead. Otherwise I would have ended

up there myself" - Stefan Konduri.

"In the quarry we worked in vain, we climbed the stones up and down again, only to torment us" - Fejzo

Toska.

"They not only collected people's teeth, but also fat. God knows what they did with it" - Ahmet Cekaj.

